

Në mbështetje të nenit 110 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Nr. 03/L-244);


Duke vlerësuar procesin e riemërimit të menaxhuar nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP) dhe duke parë nevojën për të vazhduar punën në mbështetje të udhëzimeve dhe procedurave të vendosura nga KPGJP, dhe si rezultat i mosplotësimit të të gjitha vendeve të lira të parapara për prokuror,

Me qëllim të nxjerrjes së rregullave sipas legjislacionit të zbatueshëm në bazë të të cilave do të administrohet procesi i emërimit të prokurorëve, dhe

Duke siguruar që procesi i shqyrtimit të kandidatëve për pozitat e prokurorëve të kryhet në mënyrë transparente dhe plotësisht në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut,

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) nxjerr:

RREGULLORE
MBI PROCESIN E EMËRIMIT TË PROKURORËVE



Neni 1
Dispozitat themelore

- 1.1 Qëllimi - Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e procedurave për vlerësim, verifikim dhe rekrutim të prokurorëve në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës në bazë të të cilave do të administrohet procesi i emërimit të prokurorëve.
- 1.2 Fushë veprimtaria - Përmes kësaj rregulloreje përcaktohen procedurat për rekrutimin e prokurorëve të gjitha niveleve.
- 1.3 Bashkëpunimi - Me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të parapara me këtë rregullore, Këshilli Prokurorial do të bashkërendojë aktivitetet me Institutin Gjyqësor të Kosovës, me Këshillin Gjyqësorë të Kosovës dhe me organet dhe institucione tjera relevante në Kosovë. Për këtë qëllim KPK- do të hyj në marrëveshje mirëkuptimi me të gjitha këto institucione.

Neni 2
Konkursi

- 2.1 Konkursi shpallet me vendimin e KPK-së dhe publikohet në së paku dy (2) gazeta të përditshme me shpërndarje në tërë territorin e Republikës dhe ueb faqen e KPK-es. Për qëllim të informimit të kandidatëve të mundshëm nga komunitetet jo-shumicë konkursi do të publikohet dhe / ose të transmetohet edhe në mediat të komuniteteve jo-shumicë.
- 2.2 Shpallja e vendeve të lira duhet të përmbajjë të gjitha informatat përkatëse për çdo pozitë, duke përfshirë por jo kufizuar domosdoshmërisht në detajet në vijim:
 - (a) përshkrim të secilës pozitë;
 - (b) numrin e pozitave që kërkohet të plotësohet për çdo nivel;

- (c) kriteret rreth kualifikimit për çdo pozitë;
 - (d) një shpjegim për atë se si të marrin formularin e aplikimit;
 - (e) një shpjegim për mënyrën e dorëzimit të aplikacionit;
 - (f) afati i fundit për dorëzimin e kërkesës
- 2.1 Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për pozita të caktuara për të cilat aplikojnë jo më vonë se data e skadimit të konkursit.
 - 2.2 Të gjitha aplikacionet do të regjistrohen në zyrën e pranimit të KPK-së dhe secili kandidat do të marrë një konfirmim në lidhje me aplikimin e tij / saj.
 - 2.3 Kandidatët të cilët nuk kanë kaluar me sukses testin e etikës të administruar nga KPGJP-ja nuk do të merren në konsideratë.
 - 2.4 Kandidatët që nuk paraqesin aplikacionin dhe dokumentet brenda afatit nuk do të merren në konsideratë.
 - 2.5 KPK-ja do të publikojë në faqen e saj të internetit listën e kandidatëve për secilën pozitë sipas shifrës së kandidatit.

Neni 3
Paneli i Vlerësimit

- 3.1 KPK-ja do të emërojë Panel Vlerësimi (PV) të përbërë nga tre (3) anëtarë për çdo konkurs të shpallur në radhët e të cilëve të paktën një (1) do të jetë anëtar i KPK-së.
- 3.2 Për kandidatë për nivel të Prokurorisë së shtetit, Paneli Vlerësues do të përbëhet nga Kryesuesi i KPK-së, një prokuror i shtetit dhe një anëtarë i KPK-së.
- 3.3 Për kandidatët e nivelit të Qarkut, anëtar i Panelit Vlerësues do të jetë një nga radhët e Prokurorëve të shtetit, Kryeprokurori i Qarkut nga regjioni në të cilën konkurren kandidati dhe një anëtarë i KPK-së. Ndërsa për nivel të Prokurorisë Komunale, anëtar i Panelit Vlerësues do të jetë një nga radhët e prokurorisë së Qarkut dhe Kryeprokurori i Prokurorisë përkatëse nga regjioni në të cilën konkurren kandidati dhe një anëtarë i KPK-së.
- 3.4 KPK do të vendosë në lidhje me përbërjen e Panelit Vlerësues me shumicën e votave duke emëruar edhe Kryetarin dhe zëvendës-Kryetarin e Paneli Vlerësues.
- 3.5 Kur kjo është e mundur, përbërja e anëtarëve të panelit vlerësues, pasqyron përbërjen e parimet të barazisë gjinore dhe etnike në Kosovë.
- 3.6 Anëtarët e Panelit Vlerësues dhe Panelit për Ri-konsiderim, do t'u jepet kompensim nga KPK-ja në lidhje me shpenzimet e arsyeshme si rezultat i shërbimit të tyre në procesin e emërimit. Vlera e kompensimit do të përfshijnë vetëm shpenzimet e ditës së punës dhe të transportit.
- 3.7 Procedurat Standarde të Veprimit për PV ta paraqiture si Shtojca 1 e kësaj rregulloreje paraqesin pjesë integrale të kësaj rregulloreje.

Neni 4

Zyra për Vlerësim dhe Verifikim Gjyqësor e Prokurorial

- 4.1 Këshilli Prokurorial i Kosovës, Paneli i Vlerësimit dhe Paneli për Ri-konsiderim, përkrahen nga Zyra për Vlerësim dhe Verifikim Gjyqësor dhe Prokurorial (më tutje: ZVVGjP). ZVVGjP përbëhet nga Shefi i Zyrës, Njësiti për Vlerësim Profesional që udhëhiqet nga Koordinatori i Njësitetit, Njësiti për Verifikim Gjyqësor që udhëhiqet nga Koordinatori i Njësitetit dhe stafi administrativ.
- 4.2 ZVVGjP, gjithashtu përkrahë procesin e rekrutimit të gjyqëtarëve në Këshillin Gjyqësorë të Kosovës.
- 4.3 ZVVGjP udhëhiqet nga Shefi i Zyrës nën mbikëqyrje të plotë nga Kryetari i Panelit të vlerësimit dhe Kryesuesit të Këshillit Prokurorial. Shefi i Zyrës dhe Koordinatorët e njësiveve janë përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të zyrës si dhe koordinimi dhe organizimin e aktiviteteve të saj. Shefi i zyrës dhe Koordinatorët e njësiveve emërohen nga KGJK në bashkëpunim me KPK-në.
- 4.4 ZVVGjP është përgjegjës për zbatimin e drejtë dhe korrekt të vlerësimit profesional dhe verifikimit të gjerë të biografisë së kandidatëve që aplikojnë për pozitat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, një proces i cili përfshin në vetvete mbledhje gjithëpërfshirëse të të dhënave në lidhje me njohuritë, aftësitë, performancën, të kaluarën e tij/saj, evidencën penale, të hyrat, si dhe reputacion që gëzon në vendin ku jeton dhe vepron kandidati.
- 4.5 ZVVGjP mund të zgjeroj shtrirjen e përgjegjësi, sipas kërkesave dhe nevojave të KPK-së, në mënyrë që të krijojë një sistem të përhershëm në lidhje me vlerësimin dhe verifikimin e kandidatëve të mundshëm për pozita prokuroriale.

Neni 5

Provimi pranues dhe Programi Fillestar për Arsimim Ligjor

- 5.1 KPK-ë, në bashkëpunim me IGJK-në, për pozita prokuroriale do të organizojë provim pranues për Programin Fillestar të Arsimimit Ligjor. Kandidatët që nuk e kalojnë provimin pranues apo nuk kalojnë me sukses Programin Fillestar të Arsimimit Ligjor nuk do të merren në shqyrtim të mëtejshëm për emërim.
- 5.2 Gjyqtarët dhe prokurorët që aktualisht ushtrojnë funksionin e gjyqtarit apo prokurorit, kandidatët të cilët kanë shërbyer si gjyqtar apo prokuror në çfarëdo kohe për një periudhë të pandërprerë prej së paku tre (3) vite, kandidatët të cilët kanë përfunduar me sukses Programin Fillestar për Arsimim Ligjor, janë të liruar nga provimi pranues dhe Programi Fillestar për Arsimim Ligjor.
- 5.3 Të gjithë kandidatët jashtë kategorive të cekur në nenin 5.2 të kësaj rregulloreje, e të cilët e kanë kaluar provimin pranues gjatë procesit të emërimit të administruar nga KPGJP-ja, janë të liruar vetëm nga provimi pranues gjatë procesit të emërimit të administruar nga KPGJP-ka, dhe kanë të drejtë vijimi të menjëhershëm në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor.

Neni 6
Procesi i përzgjedhjes fillestare

- 6.1 Paneli i Vlerësimit do të shqyrtojë të gjitha aplikacionet në mënyrë që të siguroj plotësimin e kushtet minimale ligjore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe eliminon të gjithë kandidatët që nuk i plotësojnë këto kushte.
- 6.2 Paneli i Vlerësimit do të njoftojë me shkrim të gjithë kandidatët të cilët nuk përmbushin kriteret në lidhje me kërkesat minimale ligjore të përcaktuara me ligj dhe si rezultat i të cilave janë eliminuar nga procesi i emërimit. Këtyre kandidatëve do të u jepet afat i përshtatshëm shtesë nëse kanë për të paraqitur prova tjera lidhur me plotësimin e kushteve dhe kriterëve formale.

Neni 7
Vlerësimi i aplikacioneve

- 7.1 Pas përpilimit të listës përfundimtare më të gjithë kandidatët që kanë plotësuar kërkesat minimale ligjore, Kryetari i Paneli Vlerësues do të kërkoj nga ZVVGJP-ja të fillojë procesin e verifikimit dhe vlerësimit të kandidatëve të listuar në kërkesë.
- 7.2 Procesi i vlerësimit përfshin shqyrtimin e të gjitha elementeve të aplikimit. Zyrtaret përgjegjës për vlerësim kontrollojnë nëse aplikimi i përmban të gjitha elementet e nevojshme. Përgjatë procesit të përgjithshëm zyrtarët përgjegjës kryejnë edhe verifikimin në komunitet dhe kontaktojnë kandidatin në rastet kur informacione shtesë janë të nevojshme. Kandidati duhet të sigurojë informata të kërkuara shtesë.
- 7.3 KPK do të nxjerrë Procedura Standarde të Veprimit lidhur me natyrën dhe fushë-veprimtarinë e vlerësimeve dhe verifikimeve të aplikacioneve të cilat do të bëhen nga ZVVGJP.

Neni 8
Përzgjedhja e kandidatëve për intervistim

- 8.1 Të gjithë kandidatët që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të intervistohen.
- 8.2 Kandidati që ka konkurruar për dy apo më shumë pozita të nivelit të njëjtë do të intervistohet vetëm njëherë. Ky rezultat do të merret parasysh kur bëhet vlerësimi i kandidatëve për atë pozitë specifike.
- 8.3 Paneli i Vlerësimit do të zbatojë të kriteret e njëjta me rastin e vlerësimit të kandidatëve dhe intervistimin e kandidatëve do ta bazojë në materialet që gjenden në dosjen e kandidatit.

Neni 9
Intervistimi

- 9.1 Një qasje e qëndrueshme metodologjike do të përdoret për intervistim të të gjithë kandidatëve që aplikojnë për të njëjtën pozitë. Pyetjet që do të shtrohen gjatë një intervistë do të jenë standarde për të gjithë kandidatët që aplikojnë për të njëjtën pozitë. Brenda pyetjeve të të njëjtës fushë mund të përdoren një sërë pyetjesh të standardizuara. Anëtarët e Panelit Vlerësues mund të shtrojnë pyetje shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna nga kandidati.

- 9.2 Paneli i Vlerësimit do të shtrojë pyetje të veçanta, të përqendruara në informatat që i ka marrë Panelit i Vlerësimit paraprakisht nga ZVVGJP dhe nga kandidati.
- 9.3 Për disa pozita nga kandidatët mund të kërkohet edhe një punim me shkrim si pjesë e procesit të intervistës.
- 9.4 Natyra e pyetjeve për fushat e caktuara si dhe pyetjet e standardizuara dhe të veçanta të cilat mund të përdoren gjatë intervistës dhe punimi me shkrim duhet të disenjohet për të nxjerrë informata që janë relevante me kriteret për emërim.
- 9.5 Vlerësimi i kandidatëve dhe llogaritja e pikëve do të bëhet sipas nenit 2 të Aneksit 1 të kësaj Rregulloreje.

Neni 10

Rangimi i kandidatëve dhe rekomandimet përfundimtare

- 10.1 Pasi të behët llogaritja e notave për secilin kandidat të intervistuar për një pozitë përkatëse, të gjithë kandidatët do të renditen sipas rezultatit zyrtar përfundimtar.
- 10.1 Vetëm kandidatët të cilët rezultati përfundimtar i vendos "MIRË" dhe mbi "MIRË" mund do të jenë te rekomanduar për emërim.
- 10.2 Numri i kandidatëve të rekomanduar nga Paneli Vlerësues mund të kalojë numrin e vendeve të lira që ekzistojnë për pozitë përkatëse për të cilin kandidatët kanë aplikuar.
- 10.3 Panelit i Vlerësimi nuk është i detyruar apo nuk kërkohet që të rekomandojë kandidatë për emërim në të gjitha vendet e lira që ekzistojnë për një pozitë përkatëse . Vetëm ata kandidatë që plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligj dhe këtë Rregullore do të rekomandohen për emërim, madje edhe në qoftë se kjo rezulton në pozita të mbetura bosh.
- 10.4 Paneli i Vlerësimit i paraqet KPK-së arsyetimin e shkurtër për secilin kandidat në mënyrë që të shpjegojë arsyet për një vendim të tillë. Kandidatët që marrin miratimin me shumicë nga KPK-ja do të rekomandohen për emërim të Presidenti i Republikës së Kosovës.
- 10.5 KPK-ja mund të kërkojë nga Paneli Vlerësues shpjegime të mëtutjeshme ose informacion shtesë.
- 10.6 Anëtarët e Panelit Vlerësues kanë të drejtë vote në KPK-së kur të vendoset për kandidatët për emërimin.
- 10.7 Paneli i Vlerësimit do të informojë kandidatët me shkrim për rezultatet e tyre të arritura gjatë intervistimit.
- 10.8 Nëse KPK-ja merr informacione lidhur me kandidatin pasi që bëhet dekretimi për emërim, informacione të cilat po të ishin bërë të ditura në kohën e emërimit të kandidatit në fjalë do të rezultonin me mos rekomandim nga KPK, Paneli i Vlerësimit do të fillojë procesin e jashtëzakonshëm për rishqyrtim. Këtë të drejtë të tërheqjes KPK-ja do ta ketë në dispozicion deri në gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike pas dekretimit nga ana e presidentit të Republikës së Kosovës.

- 10.9 Në rast se kandidati i rekomanduar nga Paneli Vlerësues nuk e merr shumicën e votave në KPK, atëherë KPK-ja do të shqyrtoj kandidatin e radhës sipas suksesit të dhënë gjatë intervistës, ose të do të ri-shpall atë pozitivë si të lirë.
- 10.10 Kandidatët të cilët nuk janë rekomanduar për emërim për pozitë të veçantë për të cilën kanë aplikuar dhe për të cilën janë intervistuar do të njoftohen nga ZVVGJP me shkrim dhe me e-mail dhe mbi arsyet pse kandidati nuk ishte i rekomanduar për emërim dhe afatin brenda të cilit kandidati mund të paraqesë kërkesë për ri-konsiderim.
- 10.11 KPK përcjell rekomandimet për emërim në Zyrën e Presidentit në përputhje me nenin 110 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të procesit të ri-shqyrtimit të paraparë me nenin 12 të kësaj Rregulloreje.

Neni 11

Kërkesa për ri-konsiderim

- 11.1 Kandidati i cili nuk i ka përmbushur kriteret ose nuk është rekomanduar për t'u emëruar si gjyqtar mund të paraqesë kërkesë me shkrim për ri-konsiderim KPK-së brenda tetë (8) ditëve pas pranimit të vendimit nga Paneli i Vlerësimit.
- 11.2 Kërkesa për rishqyrtim të vendimit mund të paraqitet në bazë të arsyeve vijuese:
- (a) Vendimi i Panelit të Vlerësimit është bazuar në gabime materiale/faktike ose mospërfshirjes së informacioneve faktike që kanë qenë në dispozicion të Panelit të Vlerësimit;
 - (b) Ekzistojnë informacione të reja të rëndësishme që kandidati nuk i ka pasur në dispozicion ose nuk i ka ditur, të cilat po t'i kishte pasur në dispozicion në kohën e vlerësimit Paneli Vlerësues do të kishte rezultuar në marrjen e një vendimi tjetër, ose;
 - (c) Panelit i Vlerësimit ka bërë një gabim të rëndë procedural gjatë zbatimit të dispozitave të kësaj Rregulloreje ose nuk i ka marrë ato në konsideratë;
 - (d) Panelit i Vlerësimit ka marrë vendimin në një situatë ku ekziston konflikt interesi, ashtu siç është përcaktuar në nenin 20 të kësaj Rregulloreje.
- 11.3 Kandidati që paraqet kërkesë për ri-konsiderim të vendimit të Panelit të Vlerësimit mbi aplikimin e tij/ saj për pozitën specifike duhet të paraqesë kërkesën për ri-konsiderim të ZVVGJP-së brenda afatit. Kërkesa për ri-konsiderim duhet të dorëzohet në formë të shkruar, me arsyetime të hollësishme.

Neni 12

Paneli për Ri-konsiderim

- 12.1 KPK-ja do të themelojë një Paneli për Ri-konsiderim (ri-vlerësim) të përbërë nga tre (3) anëtarë, nga radhët e të cilëve se paku një (1) anëtar do të jetë anëtarë i KPK-së. Në këtë përbërje duhet të jete një anëtar nga radhët e komunitetit jo shumicë në Kosovë.
- 12.2 Paneli për Ri-konsiderim do të shqyrtojë të gjitha kërkesat brenda njëzet (20) ditëve pas kalimit të afatit për dorëzimin e kërkesave për ri-konsiderim.

- 12.3 Paneli për Ri-konsiderim do të marrë vendimin përfundimtar në bazë të gjeturave gjatë ri-shqyrtimit të kërkesave për ri-konsiderim.

Neni 13

Formati i kërkesës për ri-konsiderim

- 13.1 Vetëm kërkesat me shkrim për ri-konsiderim do të merren parasysh. Kërkesa për ri-konsiderim duhet të specifikoj pozitën për të cilin kandidati është duke kërkuar ri-konsiderim dhe duhet të bazohet në një ose më shumë nga arsyet e specifikuar në nenin 11.2 të kësaj Rregulloreje.
- 13.2 Kërkesë për ri-konsiderim duhet të dorëzohet te zyrën e ZVVGjP gjatë ditëve të punës, brenda orarit të rregullt të punës.

Neni 14

Refuzimi i kërkesës për Ri-konsiderim si e pa afatshme

Nëse kërkesa nuk është paraqitur brenda afatit të përcaktuar sipas kësaj Rregulloreje kërkesa do të refuzohet automatikisht pa ndonjë proces të mëtejshëm nga ana e panelit.

Neni 15

Plotësimi i kërkesës

Pas përcaktimit se kërkesa është paraqitur në kohën dhe formën e përcaktuar sipas kësaj Rregullore, Paneli për Ri-konsiderim mund të kërkojë, nëse e sheh të nevojshme, që kandidati të plotëson kërkesën në mënyrë të përcaktuar dhe brenda kohës së caktuar nga Paneli për Ri-konsiderim. Nëse kandidati nuk i përgjigjet kërkesave të Panelit mund të hedh poshtë kërkesën për ri-konsiderim pa proces të mëtejshëm.

Neni 16

Trajtimi i kërkesave në baza meritore

- 16.1 Pasi që Paneli për Ri-konsiderim konstaton se kriteret formale për trajtimin e kërkesës janë përmbushur atëherë vendos nëse do të kërkojë informata nga Panelit i Vlerësimit ose ndonjë burim tjetër që mund të ketë informacion lidhur me kërkesën për ri-konsiderim brenda afatit të përcaktuar nga Paneli.
- 16.2 Pas pranimit të të gjitha informacioneve të nevojshme, Paneli për Ri-konsiderim nxjerr konkludimin e bazuar në materiale të shkruara dhe provave tjera të paraqitura. Paneli për Ri-konsiderim mund të ftoj për dëgjim kandidatin nëse konsideron të nevojshme. Gjate rishqyrtimit të kërkesës mbi bazën e meritës së kërkesës, Paneli do të bazohet në:
- a) Bazën e kërkesës për ri-konsiderim,
 - b) Provat e paraqitura nga kandidati
 - c) Përgjigjet/informatat e ofruara nga Paneli
 - d) Dokumentet tjera dhe deklaratat e kërkuara nga Paneli
 - e) Përmbajtja e aplikacionit
 - f) Nëse është ftuar në pyetje, të gjitha informacionet e marra nëpërmjet saj, etj.

Neni 17
Shqyrtim gojor

- 17.1 Paneli për Ri-konsiderim do të caktojë datën kur kandidati do të ftohet për dëgjim. Në ftesën e Panelit mund ta shënohet edhe qëllimi i ftesës. Kandidati mund ti sugjerojë Panelit dëshmitarët për t'u dëgjuar. Paneli për Ri-konsiderim do të ketë diskrecionin te plotë nëse do të i ftojë në pyetje dëshmitarët. Paneli ka të drejtë të ftojë dëshmitarët e tjerë me iniciativën e vet ose mund të kërkoj nga ZVVGjP-në për të kryer një intervistë me një dëshmitar të caktuar.
- 17.2 Kandidatit do të ftohen për dëgjim lidhur me çështjet e ngritura në kërkesën e tij për ri-konsiderim. Pas kësaj Paneli për Ri-konsiderim mund të paraqes prova tjera që i përcakton si të rëndësishme. Kandidati ka të drejtë për të komentuar në të gjitha provat e reja.

Neni 18
Sigurimi i provave

Barra për sigurimin dhe paraqitjen e provave në përkrahje të kërkesës për ri-konsiderim bie mbi kandidatin. Në qoftë se ka prova të qarta dhe bindëse se kërkesa për ri-konsiderim është e bazuar atëherë Paneli për Ri-konsiderim e pranon kërkesën.

Neni 19
Vendimi

Lidhur me vendimin e Panelit për Ri-konsiderim, kandidati njoftohet me shkrim.

Neni 20
Konflikti i interesit

- 20.1 Këshilli Prokurorial i Kosovës, Panelit i Vlerësimit dhe Ri-konsiderimit duhet të deklarojnë menjëherë çfarëdo lloj konflikti të interesave në formë të shkruar gjatë procesit të përzgjedhjes dhe të tërhiqet nga pjesëmarrja e tyre në çdo Panel apo seance të KPK-së, çdo herë kur përfshihet në situatat e konfliktit të interesit.
- 20.2 Konflikt interesi është lidhja, farefisnia apo rrethana publike apo private, përfshirë marrëdhëniet familjare, shoqërore, financiare dhe profesionale, që do të shkaktonte një personi të arsyeshëm, i informuar për të gjitha faktet, të besojë se një anëtar i Panelit të Vlerësimit ose Ri-konsiderimit nuk do të jetë në gjendje të jetë objektiv, i drejtë dhe i paanshëm në vlerësimin e kualifikimeve të kandidatit.
- 20.3 Konflikti i interesit ekziston ndërmjet detyrimit të KPK-së, Panelit të Vlerësimit dhe Panelit për Ri-konsiderim të jetë i drejtë, objektiv dhe i paanshëm dhe kur ndonjëri prej anëtarëve njihet personalisht ose ka çfarëdo lloj marrëdhënie me një kandidat dhe kur kjo njohje personale ose marrëdhënia me atë kandidat mund të ndikojnë vërtetë ose duket të ketë shumë gjasa të ndikojë në aftësinë e anëtarit për të vlerësuar kualifikimet e kandidatit në mënyrë të drejtë, objektive dhe të paanshme duke u bazuar vetëm në merita.

- 20.4 Konflikti i interesit ekziston kur një anëtar i KPK-së apo Panelit të Vlerësimit apo Ri-konsiderimit me kandidatin ka lidhje gjaku, martesore ose familjare brenda shkallës së tretë ashtu siç është përcaktuar më tabelën e Konfliktit të Interesit të paraqitur në Shtojcën 3 të kësaj Rregulloreje.
- 20.5 Konflikti i interesit ekziston kur një anëtar i KPK-së apo Panelit të Vlerësimit apo Ri-konsiderimit aktualisht shërben ose ka shërbyer më parë në Prokurorinë e njëjtë si kandidati, anëtari do të informojë menjëherë KPK-në.
- 20.6 Konflikti i interesit ekziston kur sa herë që një anëtar i caktuar ne Panelin e Vlerësimit ose Panelin për Ri-konsiderim aktualisht shërben ose ka shërbyer më parë në një pozicion i cili përfshin apo ka përfshirë, vlerësimin e punës së tij/saj apo ka qenë mbikëqyrës i tij/saj.
- 20.7 Konflikti i interesit ekziston kur një anëtar i KPK-së, Panelit të vlerësimit ose Ri-konsiderim:
- (a) aktualisht është i angazhuar ose ka qenë i angazhuar në një biznes publik ose privat, ortakëri, ndërmarrje ose ndonjë biznes tjetër apo veprimtari të ngjashme me kandidatin, ose
 - (b) aktualisht ka apo më parë kishte një interes financiar, biznesit, partneritet, ndërmarrje ose sipërmarrje të ngjashme ose ndonjë veprimtari në të cilat kandidati është ose ka qenë e përfshirë.
- 20.8 Vendimi në lidhje me largimin e anëtarit të KPK-ës, Panelit të Vlerësimit dhe Panelit të Ri-konsiderim për shkak të konfliktit të interesit do të bëhet nga KPK-ja.

Neni 21

Komunikimi gjatë procedurës së përzgjedhjes

- 21.1 Anëtarët e Këshillit Prokurorial i Kosovës, Paneli për Vlerësimi dhe Panelit Ri-konsiderim nuk mund të hyjnë në çdo lloj komunikimi me kandidatët ose me individë ose organizata që dëshirojnë ta mbrojnë apo të japin informacion në favor ose kundër një kandidati.
- 21.2 Kandidatët duhet të përmbahen nga komunikimi me anëtarët individual. Kandidatët duhet të udhëzojnë miqtë, të afërmit dhe kolegët e tyre të mos komunikojnë në emër të tyre me cilin do anëtarë individual.

Neni 22

Qasja e autorizuar në të dhënat personale dhe konfidencialiteti

- 22.1 Vetëm anëtarët e KPK-së, Paneli i Vlerësimit, Paneli për Ri-konsiderim dhe zyrtarët e ZVVGjP-së mund të kenë (apo kanë) qasje në të dhënat personale të kandidatëve deri në atë shkallë me qëllim të kryerjes së detyrave pavarësisht se ku gjinden fizikisht të dhënat.
- 22.2 KPK dhe ZVVGjP do të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të garantuar nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale, siç përcaktohet në Ligjin Nr 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale.
- 22.3 Të gjitha dosjet dhe arkivat do të mbahen nën masa sigurie.
- 22.4 Anëtarët e KPK, Panelit i Vlerësimit, Ri-konsiderim dhe ZVVGjP nuk do të bëjnë asnjë akt apo formë të deklarimit publik të cilat mund të ndikojnë në dëmtimin e procesit të emërimit.

Neni 23

Ankesat

Në rast se ZVVGjP-ja pranon ndonjë ankesë për sjellje të pahijshme kundër kandidatit, kur ai / ajo ushtron një funksion prokurorial, ankesa do të dërgohet në Zyrën e Prokurorit Disiplinor (ZPD). Në rastet e pranimit të ankesave kundër kandidatëve që nuk ushtrojnë një funksion gjyqësor, ankesa origjinale përcillet tek autoriteti kompetent.

Neni 24

Bashkëpunim i brendshëm

Të gjitha njësitet brenda KPK-së, duke përfshirë edhe zyrat e pavarura, komisionet, prokuroritë e të gjitha niveleve, do të bashkëpunojë ngushtë me Panelin e Vlerësimit, Ri-konsiderim dhe ZVVGjP për t'iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave të tyre .

Neni 25

Dispozitat kalimtare

- 25.1 Kjo rregullore dhe Anekset e saja vlejnë për qëllim të plotësimit të pozitive të lira të ngelura si të paplotësuara nga procesi i emërimit dhe riemërimit të administruar nga KPGJK-ja, por jo me vonë se dymbëdhjetë muaj pas shpalljes së vendeve të lira (ose deri në plotësimin e vendeve të lira)
- 25.2 Më hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet çdo akt normativ që është në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.
- 25.3 Kjo rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet me vendim të KPK-së.

Neni 26
Hyra në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me datën 04/03/2011.

Ismet Kabashi
Ismet KABASHI
Kryesues
Këshilli Prokurorial Kosovës

